

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Lende Djegese PELET

per Bashkine Bulqize dhe institucionet vartese (shkollat,kopshtet,cerdhet)etj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09110000-3, Lëndë djegëse të ngurta

VLERA E FONDIT LIMIT:

7 500 000(Shtatemilione peseqind mije) Lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Bulqize**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularipërmbledhësivetdeklarimit,sipas shtojcës 8

b. Sigurimoferte, sipasShtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (**2019, 2020, 2021**) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet taktivit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dybilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që *bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"* i ndryshuar.

2.2.2 Për të provuar se operatorëkonomikëkanëkapacitetin e nevojshëmekonomikdhefinanciarpërtëzbatuarkontratën, duhet të paraqesin kopje tëdeklaratavetëxhirosvjetoretërealizuarngaoperatoriekonomikpërnjëperiudhëmaksimumiderinë 3 (tre) vitet e funditfinanciarepërkatësisht(**2019, 2020, 2021**) nënjë vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet Kërkesapërplotësimin e kapacitetevefinanciarekonsiderohet e përmbushurnëseoperatorëkonomikëarrijnëvlerën e xhirosminimale, nëtëpaktënnjë vit tëperiudhëssëkërkuarngaautoriteti/entikontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.Shënim:Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për

tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shenohen data, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1 (një) kampion në paketim origjinal për produktin objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të

përmbajë: mostër “emri i artikullit”, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostra duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga pesha dhe rëndësia që ato kanë për mbarëvajtjen e proceseve të punës. Në këtë rast ky produkt është konsideruari e nevojshme nga autoriteti kontraktor për t’u paraqitur mostra në paketim origjinal.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme dhe duke u mbështetur në Skemën e Çertifikimit të cilësisë së lëndës djegëse Pelet .Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Kërkesat për paketimet, etiketimet dhe dokumentacionin shoqërues të mallrave objekt prokurimi janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi, referuar Ligjit nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, Ligjit nr. 10489 datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.